



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRIZREN - DEGA E GJYKATËS SUHAREKË

Numri i lëndës: 2018:050455

Datë: 21.06.2019

Numri i dokumentit: 00370907

**P.nr. 26/18**

**NË EMËR TË POPULLIT**

Gjykata Themelore Prizren – dega në Suharekë, gjyqtari Robert Tunaj me sek. Juridike F. Kabashi, duke vendosur në lëndën penale kundër të akuzuarit Q. I. G. nga fshati L., për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtim i pasuris nga neni 333 par. 1 të KP, e duke vendosur sipas aktakuzës të PTH në Prizren PP.II.nr.7-9/18 të dt.18.01.2018, në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.20.06.2019, në prezencë të PSH Beqë Shala, të akuzuarit, mori dhe publikisht shpalli,ndërsa me datën 21.06.2019 përpiloi këtë:

**A K T G J Y K I M**

I akuzuari Q. G., nga i ati I., e ëma H., e lindur F., i lindur me dt. 21.12.1989, nga fsh. L., ka të mbaruar arsimin e mesëm, punëtor, i gjendjes jo të mirë ekonomike, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

**ËSHTË FAJTOR**

Se me dt. 20.12.2017 rreth orës 01,30 minuta në fshatin Sh. – Komuna e Suharekës, saktësisht në restorant “A.- P.” ia asgjëson, dëmton dhe benë të papërdorshëm pasurinë e të dëmtuarës “A. – P.”, në atë menyrë që për shkak të një mosmarrëveshje që kishte lidhur me një borgjë, hynë në restorant dhe me një thikë i dëmton 3 (tre) ulëse dhe pastaj largohet nga vendi i ngjarjes, me çrast me këto veprime të dëmtuarës - i shkakton dëm material.

-Më këtë ka kryer veprën penale asgjësimi apo dëmtim i pasuris nga neni 333 par. 1 të KP.

Andaj gjykata konform dispozitave të nenit 41,46,73,74, si dhe nenit 333 par. 1 të KP, të akuzuarit, ia shqipton:

**DENIM ME GJOBË**

Të akuzuarit Q. G. i shqiptohet denimi me gjobë në shumë prej 100 € (njëqind Euro).i cili denim do të ekzekutohet në afatin prej 15 ditësh, nga dita e plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi, poqëse denimi me gjobë nuk mund të realizohet as detyrimisht, i njejt i do të zëvendësohet me denim burg prej 5 ditësh, duke llogaritur për 20 €, të filluar me një ditë burgimi, konform nenit 46 paragrafi 3 te KP

Obligohet i akuzuari me shpenzimet e procedurës, në emër të paushallit gjyqësor shumë prej 20 € dhe taksën për viktimat e krimit shumë prej 30 €, të gjitha këto, pas plotëfuqishmeris së këtij aktgjykimi.

E dëmtuara “A. – P.” nga Sh., për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest të rregullt civil.

## **A r s y e t i m**

PTH në Prizren me aktakuzën PP.II.nr. 7-9/18 të dt. 18.01.2018, ka akuzuar Q. I. G. nga fshati L., për shkak të veprës penale asgjësimi apo dëmtim i pasuris nga neni 333 par. 1 të KP, aktakuzën të cilën gjate séancës gjyqësore prej fillimit gjer në mbarimin e saj e ka përfaqësuar PSH Beqë Shala, i cili në tërsi ngel pran të dhënave si në aktakuzë, i akuzuari të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Gjykata në shqyrtimin gjyqësor të mbajtur me dt.20.06.2019 dhe vetë pranimin nga ana e të akuzuarit, ka vërtetuar këtë gjendje faktike:

Se me datë 20.12.2017 rreth orës 01,30 minuta në fshatin Sh. – Komuna e Suharekës, saktësisht në restorant “A.- P.” ia asgjëson, dëmton dhe benë të papërdorshëm pasurinë e të dëmtuarës “A. – P.”, në atë menyrë që për shkak të një mosmarrëveshje që kishte lidhur me një borgjë, hynë në restorant dhe me një thikë i dëmton 3 (tre) ulëse dhe pastaj largohet nga vendi i ngjarjes, me çrast me këto veprime të dëmtuarës - i shkakton dëm material.

Këtë gjendje faktike gjykata e ka vërtetuar nga vetë pranimi i të akuzuarit i cili në shqyrtim gjyqësor ka pranuar fajsin.

Gjykata sipas detyrës zyrtare konform nenit 259 të KPP në shkresat e lëndës nuk ka gjetur ndonjë provë të pa pranueshme dhe poashtu gjykata ka vërtetuar se i akuzuari ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimin të fajsis, pranimi i fajit nga ana e të akuzuarit është bërë vullnetarisht në shqyrtimin gjyqësor, pranimi është mbështetur në faktet e qështjes që përmban aktakuza siq janë raporti i fornetzikes me nr. DM-8.-8.. të dt. 20.12.2017, vërtetimi mbi sekuestrimin e përkohshëm të sendeve të dt. 20.12.2017 si dhe fotoalbumi, dhe shkresat të cilat gjinden në lëndë si prova materiale të paraqitura ndaj të akuzuarit nga ana e PTH në Prizren.

Gjykata poashtu në tërsi ka ardhur në përfundim se pranimi i fajsis në shqyrtimin gjyqësor nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me dispozitat e nenit 326 dhe pranimi i fajsis është bërë në menyrë vullnetare i vetëdijshëm dhe në përputhje me nenin 248 nga se nuk egziston ndonjë nga arsyerat dhe kushtet për hüdhen e aktakuzes, apo pushimin e procedurës penale si dhe nenit 253 të KPP. Dhe nga këto fakte të cilat i përmban aktakuza, gjykata ka ardhur në përfundim se me veprimin e të akuzuarit formohen të gjitha elementet e qënjes së veprës penale asgjësimi apo dëmtimi i pasuris nga neni 333 par. 1 të KP, gjykata ka vendosur të akuzuarin ta shpallë fajtor dhe ia shqiptoi denimin siq është cek në aktgjykim.

Gjykata gjatë marrjes së vendimit mbi denimin ka vlersuar të gjitha rrethanat në kuptim të nenit 73 dhe 74 të KP.

Gjykata si rrethanë letësuese pati parasyshë se i akuzuari ka patur qëndrimin korrekt ndaj gjykatës, pranimin në tërsi të veprës se kryer, është penduar për veprën e kryer, është familjar, i pa punë dhe i gjendjes së dobët ekonomike ,kurse rrethan posaqerisht rënduese nuk gjeti.

Vendimi mbi kërkesen pasuroro juridike u muarrë në kuptim të nenit 463 të KPP.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës u muarrë në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP.

Vendimi me të cilin është i obliguar i akuzuari që të bëjë kompenzimin e viktimave të krimit është marr konform nenit 39 par. 3 nën par. 3.2 të Ligjit për kompenzimin e viktimave të krimit.

**GJYKATA THEMELORE PRIZREN – DEGA NË SUHAREKË**

Departamenti i përgjithshëm

P.nr. 26/18 të dt. 20.06.2019

Sek. Juridike  
F. Kabashi

G j y q t a r i  
Robert Tunaj

**UDHËZIME JURIDIKE:**

Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Prishtinë, në afat prej 15 ditësh, llogaritur nga dita e pranimit të tij ankesa dorëzohet përmes kësaj gjykate, në kopje të mjaftushme për palët dhe gjykatën.